



Njoftim

UNDP / UNV dhe Fakulteti Filozofik, Universiteti i Prishtinës, do të bashkëpunojnë në zbatimin e aktivitetit "Bashkë-dizajnim në reduktimin e ndotjes së ajrit", që është pjesë e projektit të përbashkët të UNDP/UNV dhe WHO "Healthier Kosovo 2".

Aktiviteti parasheh angazhimin e UN Vullnetarëve të Komunitetit, që do të angazhohen në aktivitete inovative, të cilat do të implementohen në nivel të komunitetit.

Në vijim mund të gjeni më shumë informata rreth kësaj mundësie, si dhe mënyrës së aplikimit.

Tituli: UN Vullnetar i Komunitetit për bashkë-dizajnim kundër ndotjes së ajrit

Numri i pozitive të hapura: 13

Vendndodhja: Prishtinë

Kohëzgjatja e angazhimit: 9 muaj

UN Vullnetari i Komunitetit do të angazhohet në aktivitete inovative, të cilat do të implementohen në nivel të komunitetit, ku ata do të sigurojnë kontakt të drejtpërdrejtë me komunitetin dhe ndërgjegjësim në lidhje me ndotje të brendshme/jashtme të ajrit.

Përshkrimi i detyrave: Nën mbikqyrjen e drejtpërdrejtë të Zyrtares së Inovacionit të Projektit të UNDP-së, UN Vullnetari i Komunitetit do të:

- Vijojë e trajnimet lidhur me proceset dhe aktivitetet e implementuara nga projekti Healthier Kosovo 2, ku fokusi do të jetë në aktivitete të bashkë-dizajnit;
- Marrë pjesë në mënyrë interaktive në takimet ideuese dhe seancat hulumtuese të përbashkëta;
- Kryejë hulumtime në teren dhe të bëj mbledhjen e të dhënave në nivel të komunitetit;
- Marrë pjesë në punëtoritë bashkë-krijuese dhe të ofrojë mbështetje në implementimin e prototipeve të përzgjedhura;
- Asistojë në ndërgjegjësimin dhe informimin e komuniteteve lidhur me ndotjen e ajrit;
- Ndërtojë raporte efektive me komunitetin;
- Mbajë shënime dhe raportoje mbi aktivitetet dhe praktikat më të mira;
- Kryejë çdo detyrë tjetër të ndërlidhur me përshkrimin e punës siç mund të kërkohet ose caktohet nga mbikëqyrësi.

**Kriteret:**

- Student i vitit të fundit në nivelin Bachelor apo student i nivelit Master në degën e psikologjisë, sociologjisë, filozofisë apo punës sociale;
- Njohuri bazike mbi metodat e hulumtimit dhe përvojës në mbledhjen e të dhënave në terren;
- Aftësi të mira komunikimi;
- Njohuri themelore i aplikacioneve Office të kompjuterit;
- Shërbimi vullnetar dhe përvoja në angazhimin në komunitet konsiderohen një përparësi;
- Zotërimi i mirë i gjuhës së punës në komunën përkatëse.

Orari i punës: Gjysmë-orari: (2.5 ditë /javë).

Benefitet:

- Kompensimi për punë vullnetare, që mbulon shpenzimet e jetesës;
- Sigurimi shëndetësor për të gjithë kohëzgjatjen e kontratës;
- Mundësi për trajnime;
- Pushim vjetor.

Procedura e aplikimit:

Shënim: UN Vullnetarët e Komunitetit shërbejnë në vendin, ku ata jetojnë. Prandaj, kandidatët, që mund të aplikojnë për këto pozita të hapura, duhet të jenë banorë të Prishtinës apo të jenë me banim në Prishtinë gjatë gjithë periudhës së angazhimit.

Për të aplikuar, dorëzoni dokumentet e mëposhtme përmes emailit në application.unv@gmail.com **deri 18 gusht 2022:**

- CV-në (mundësisht në EU format)
- Kopjen e skanuar të letërnjoftimit
- Konfirmimin e statusit të papunësisë (Për të marrë konfirmimin e statusit të papunësisë, duhet të regjistroheni në Zyrën e Punësimit në komunën tuaj dhe të merrni këtë konfirmim).
- Vërtetimin nga fakulteti, që konfirmon të qenit student i vitit të fundit i nivelit bachelor apo student i nivelit Master në degët e sipër shënuara.

Kur ta dërgoni aplikacionin përmes emailit, shënoni në "subject" - "Aplikimi për UN Vullnetar të Komunitetit në Prishtinë".)

Shënim i rëndësishëm:

- Aplikacionet të pa kompletuara nuk do të merren parasysh
- Vetëm kandidatët, që plotësojnë kriteret e cekura më lart do të konsiderohen për t'u intervistuar
- Të gjitha aplikacionet e pranuar do të shqyrtohen, si dhe procesi i rekrutimit dhe selektimit do të menaxhohet nga zyra e UNV-së dhe UNDP-së në Kosovë.